



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar Prijemeno/Prodato Received/Delivered	15.03.2023	3	Viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	2719/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.412/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Vjollca Sinani-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.412/2023 të datës 24.02.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë "[redacted]", Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme-Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në çështjen juridike "Kompensim material", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.412/2023 e datës 24.02.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted].

A r s y e t i m

Ankuesja Jita [redacted] e punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike në kuadër të Ish. Ministrisë së Administratës Publike tash në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në pozitën sipas aktemrimit të datës 18.09.2013 më datë 24.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2045/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e punës shtesë për faktin se kryen punën e Asistentes Ekzekutive në Institutin e Kosovës për Administratë Publike duke ju referuar Udhëzimit Administrativ nr.08/2006 që ka të bëjë me masat për shtimin e efikasitetit në administratën Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 412/2023 të datës 24.02.2023, me numër të protokollit 2045/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Email i datës 01.02.2023 (katër Emaila); Kërkesën për shtesë në pagë në organin e punësimit e datës 25.01.2023; Akt Emërimit e datës 18.09.2013 të ankueses; Kërkesë e datës 09.03.2023 për prova shtesë e dërguar nga ankuesja përmes Emailit me numër protokollit 2551/2023; Emailin e datës 25.01.2023; Kërkesë për përgjigjeje në ankesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i datës 28.02.2023; Përgjigjeje në ankesë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 07.03.2023; Akt Emërimit e datës 17.09.2014 të ankueses; Kërkesë për kompensim në vendin e punës e datës 07.01.2023; Kërkesë për kompensim në vendin e punës e datës 28.01.2019; Emailat e datës 05.02.2019 dhe 09.07.2019; Email i datës 26.07.2019; Udhëzimin Administrativ Nr.08/2006.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 18.09.2013 është e punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike në kuadër të Ish. Ministrisë së Administratës Publike tash në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ndërsa sipas shkresave të lëndës, fillimisht më datë 25.01.2023 ankuesja ka parashtruar kërkesë përmes Emailit për shtesë në pagë bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.08/2006 Masat për shtimin e Efikasitetit në Administratë Publike, mirëpo nuk ka marr ndonjë përgjigje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: "1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj", nenin 125 paragrafi 1 ku shprehimisht potencohet: "1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"), si dhe nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, dhe rrjedhimisht duke marr parasysh konstatimin si më lartë se ankuesja me datë 25.01.2023 ka parashtruar kërkesë përmes Emailit për shtesë në pagë bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.08/2006 Masat për Shtimin e Efikasitetit në Administratë Publike, ndërsa për shkak të heshtjes administrative me datë 24.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative-heshtja administrative, kështu që bazuar në arsyet si më lartë ankesa e ankueses është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.412/2023, datë 15.03.2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Institutin të Kosovës për Administratë Publike, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

